

## **DRAFTI I**

# **RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS**

## **TE AKTIVITETIT:**

**“Perpunim mishi”**







**Subjekti:** “ Pro Fast ” sh.p.k

**Vendndodhja:** Korce, Drenove, Boboshtice

**Tirane, 2016**

# **PERMBAJTJA**

-  Hyrje
-  Baza ligjore
-  Metodika e vleresimit te mjedisit
-  Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrushem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

## **“Perpunim mishi”**

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*

- VKM nr.419 date 25.6.2014 « *Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja* ».
- Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” *Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis*”.

## **1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

### ➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti ”**Pro Fast**”sh.p.k do te ushtroje aktivitetin per **Perpunim mishi**. Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore.

### **Pershkrimi i qellimit te propozuar**

Fabrika eshte e ndertuar me konstruksion metalik dhe e veshur me panele sanduic. Ambjentet jane te shtruara me tapet industrial me lende hipokside te pershtateshme per industrine ushqimore. Ne kete fabrike procesi teknologjik eshte organizuar ne reparte. Aktiviteti merr ne konsiderate masat e nevojshme per te siguruar qe menaxhimi i tyre te kryhet pa demtuar shendetin e njeriut dhe pa i sjell deme mjedisit vecanerisht:

- Pa krijuar rreziqe per ujin, ajrin, token, floren ose faunen
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat
- Pa demtuar peisazhin

Nje synim tjetër eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike organizative per zbutjen e ndikimeve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit. Në fabriken e perpunimit te mishit te shoqerise “**Pro Fast**” sh.p.k. do te punonesoje njerez te profesioneve te ndryshme si:


- Teknolog
- Punonjes paketimi
- shofer
- punetor te thjeshte.

Për të krijuar një ambient pune optimal dhe mbrojtjen nga aksidentet, shoqeria “**Pro Fast**” sh.p.k ka pajisur të gjithë punonjësit që punojnë në prodhim me uniformë, kapele. Numri i punonjesve deri ne 34 punonjes ose dhe me shume nese do te jene te nevojshem .

## Pershkrimi i aktivitetit "Perpunim mishi"

Fabrika eshte e ndertuar me konstruksion metalik dhe e veshur me panele sanduic. Ambjentet jane te shtruara me tapet industrial me lende hipokside te pershtateshme per industrine ushqimore. Ne kete fabrike procesi teknologjik eshte organizuar ne reparte sipas skemes se meposhtme:

### Skema Teknologjike



Si lende te para fabrika perdor mishin e gjedhit, derrat dhe yndyrna te ndyshme. Ndersa si lende ndihmese kripen, miks fosfatesh, mishelat e erzave etj.

Mishi pasi del nga frigoriferi i lendes se pare hyn ne dhomen e shkrirjes, ku hapet neper rrafte te posacme, per tu zbutur dhe per tu bere gati per perpunim.

Me pas nga dhoma e shkrirjes dhe pastrimit kalon ne ambientin e prerjes ku pasi kalon ne makinen prerese, grumbullohet neper arka plastike.



Pas peshimit kalon ne procesin e marinimit, ku shtohen erezat dhe perzihet.

Me pas mishi i marinuar del nga perzieresi dhe vendoset ne kazane inoksi.

Nga kjo faze kalon ne procesin termik, ku sipas llojit te produktit i nenshtrohet tharjes ose zjerjes.

Kur arrihen parametrat e standartit kalon ne procesin e maturimit ku ruhet ne temperature  $4^{\circ}\text{C}$  dhe eshte i gatshem per paketim. Paketimi i produktit realizohet ne vakum me ambalazh sintetik i tipit PAPE (poliamidopolietilen) qe ka nje cikël biodegradimi shume me te shkurter se PVC (polivinilcloruri).

Nga dhoma e paketimit produktet magazinohen ne frigoriferin e gjendjes ku ruhen ne temperature  $4^{\circ}\text{C}$ , para se te dalin ne treg ne baze te porosive te marra.



## **2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

### **Pozita gjeografike**

Qyteti i Korçës shtrihet ne pjesën juglindore te Shqipërisë dhe është qendra e banuar më e madhe e pellgut me të njëjtin emër. Pellgu i Korçës ka një lartësi mesatare prej 850m mbi nivelin e detit, me gjërësi 16 km nga perëndimi në lindje dhe me gjatësi 35 km nga jugu në veri, dhe zë një sipërfaqe prej 300km<sup>2</sup>. Korça ka një pozite te favorshme gjeografike pasi ndodhet ne rrugët tregëtare që lidhin Shqipërinë me Maqedoninë (47km) dhe Greqinë(35km). Fusha e Korces eshte nje nder fushat me te medha ne Shqiperi. Malet zene 58% te siperfaqes, kodrat 17% dhe fushat 25%.

### **Cilesia e ajrit,temperature,reshjet atmosferike.....**

Korca ka klimë mesdhetare kalimtare (ose klimë mesdhetare kontinentale) me ndryshime të mëdha në temperaturë. Muaji më i nxehtë është gushti (25°C) ndërsa muaji më i ftohtë është janari (8°C). Mesatarisht gjatë vitit bien 700 mm reshje të cilat minimumin e arrijnë në verë ndërsa maksimumin në dimër, duke e bërë Korcen një qytet përgjithësisht të thatë krahasuar

me pjesën tjetër të Shqipërisë së lagësht. Temperaturat në Korce që përthith 2000 orë rrezatimin diellor, përgjithësisht mbeten më të ulta se pjesa tjetër e Shqipërisë perëndimore, por më të larta se pjesa veri-perëndimore për shkak të lartësisë mesatare në rrafshin e Bilishtit.

Korce - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrikk	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Temp. Maks. (°C)	4	7	8	14	19	24	28	29	22	17	10	6	Ø 15,7
Temp. Mini. (°C)	-3	-2	-1	4	9	12	14	15	11	7	3	-1	Ø 5,7
Reshje (mm)	58	89	51	53	99	25	18	10	51	81	132	53	Σ 720

### Flora dhe fauna

Dominojnë drurë si bredhi i Maqedonisë (*Abies borisi Regis*), që ndodhet i kufizuar në Shqipërinë Juglindore, pisha e zezë, panja dhe tisi (*Taxus bacata*) që është tepër i rrallë. Këtu rritet numri më i madh i gjitarëve në Shqipëri. Ka vlera të pakrahasueshme për zhvillimin e ekoturizmit, sporteve dimërore, alpinizmit dhe ekskursioneve. Zona e Prespës është shpallur me vendim qeverie si zonë turistike dhe Park Kombëtar, ku natyra ka dhuruar dhe harmonizuar pyllin dhe liqenin të cilat krijojnë mundësi zhvillimi për një turizëm rural gjithëvjetor.

### Burimet ujore

Rajoni i Korces laget nga liqene, lumenj dhe perrenj te ndryshem:

- Liqeni i Ohrit
- Liqenet e Prespes se madhe dhe te vogel
- Lumi i Devollit
- Lumi i Dunavecit

Rezervat ujore te ketij rajoni perbehen prej dy burimesh furnizimi:

1. Furnizimi nepermjet shtresave ujembajtese nentokesore te cilat aktualisht sot perdoren per



uje te pijshem dhe ne prespektive mund te perdoren per ujitjen e zonave.

2. Furnizimin nepermjet ujrave siperfaqesore qe dalin nepermjet burimeve malore apo fushore. Pjesa me e madhe e ketyre burimeve perdoren per uje te pijshem me rrjedhje te lire ose ngritje mekanike. Me baze nga keto burime jane dhe rrjedhat e lumenjve te Devollit-Osumit-Dunavecit-Tushemishtit e perrenj te tjere.

- **Burimet nentokesore**

Zona e Korces eshte e pasur me burime nentokesore te tipit metalor dhe jo metalor

- Metalore: baker, hekur nikel, krom, dhe nikel silikat
- Jo metalore: gur talku, asbest, rere kuarcore.
- Jo metalore energjitike: qymyrguri
- Jo metalore (materile ndertimi dekorative) argjila per tulle, gure gerqeror per ndertim, guri i kuq i Polenes, guri i shtufit, zhavore, rera per beton etj.

## **1. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

- **Ndikimet ne popullsi**

Si rrjedhoje e zbatimit te aktivitetit nuk parashikohen ndikime pasuese mjedisore apo sociale tek popullata e zones. Projekti nuk ka ndikime ne popullsine e zones apo zhvendosje te saj, per shkak te ketij aktiviteti mbasi zona nuk eshte zone urbane apo toke bujqesore.

Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti eshte larg qendrave te banuara dhe nuk sjell shqetesime per ta vecse rrit mundesine e punesimit te tyre , duke rritur keshtu nivelin ekonomik te ketyre familjeve. Zhvillimi i ketij aktiviteti do te sjell te mira e sherbime jo vetem per investitorin por edhe per komunitetin. Teknologjia e aplikuar per therjen e kafsheve ndikon pozitivisht pasi ofron mish te cilesise se larte.

- **Ndikimet ne klime**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat qe krijohen jane si rezultat i levizjes se makinave te transportit , zhurma te tjera nuk ka gjate zhvillimit te aktivitetit.

- **Ndikime nga shkarkimi i ujerave**

Gjate zhvillimit te ketij aktiviteti do te kemi ujra te perdorura gjate pastrim te cilat do te kalojne ne nje grope dekantuese dhe nga aty do te kalojne te pastra ne mjedisin ujqor prites. Ujrat qe vijne nga perdorimi i perditshem i personelit,i bashkohen ujerave te rrjetit te kanalizimeve.

- **Ndikimet ne toke**

Mbetjet e ngurta perfaqesohen kryesisht nga materiale plastike dhe kartoni me te cilat jane ambalazhuar lenda e pare dhe lendet ndihmese. Ato grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas mblidhen nga personat e caktuar nga pushteti vendor, per ne vend depozitimet perkatese

- **Ndikimet ne ajer**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk kemi aktivitet prodhues qe te gjeneroje gaze ne atmosfere, pra nuk do te kete ndikime negative ne ajer si rezultat i ketij aktiviteti.

- **Ndikimet e projektit ne rruget lokale dhe te transportit.**

Si nje zone me zhvillim te vogel urban infrastruktura eshte pak e zhvilluar. Aktiviteti qe zhvillohet nuk shkakton mbingarkim ne sistemin rrugor.

- **Ndikimi i projektit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi veprat e tjera njerzore**

Projekti i propozuar nuk ka ndikime ne habitatet e zones. Ai nuk prish koridore biologjike dhe as nuk demton peizazhin natyror te zones.

- **Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare**

Nga zhvillimi i aktivitetit , ne zonen ku zhvillohet dhe territorin per rreth, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet. Objekti eshte ne brendesi te territorit te Republikes se Shqiperise, prandaj dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

- **Ndikimet ne perdorimin e tokes**

Ky aktivitet nuk ka ndikim negative ne perdorimin e tokes bujqesore, nuk do te perdoret siperfaqe tjeter toke pervec asaj te miratuar per kete qellim.

- **Ndikimet ne ekonomi**

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky aktivitet do te sjell ndikime pozitive ne ekonomi duke rritur te ardhurat jo vetem te investitorit por duke punesuar edhe punonjes nga zona perreth rrit nivelin e tyre te jetes.

## **2. MASAT PER ELEMENIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

### **➤ Masat per ndikimet negative ne mjedis**

Me qellim qe te parandalohen , shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marre masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

#### **○ Gjelberimi i territorit**

Per eliminimin e aromave te pakendeshme nga ana e shoqerise eshte ber e mundur gjelberimi i sipërfaqes me lule dekorative dhe gjelberim te perhershëm. Per mirembajtjen e tyre tregohet nje kujdes i vecante nga ana e personelit.

#### **○ Mbetjet e ngurta**

Mbetjet e ngurta perfaqesohen kryesisht nga materiale plastike dhe kartoni me te cilat jane amballazhuar lenda e pare dhe lendet ndihmese. Ato grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas mblidhen nga personat e caktuar nga pushteti vendor, per ne vend depozitimet perkatese

#### **○ Grumbullimi ujerave**

Gjate zhvillimit te ketij aktiviteti nuk kemi shkarkime te ujerave te ndotur. Ujerat qe vijne nga perdorimi i perditshem i personelit, si dhe ujrart qe vijne nga pastrimet i bashkohen ujerave te rrjetit te kanalizimeve. Ujerat e shiut drejtohen permes kanalizimeve drejt kolektorit kryesor sebashku me ujerat e perdorimit nga aktiviteti njerezor.

#### **○ Kushtet e punes**

Investitori ka krijuar kushte te favorshme pune per punonjesit e tij. Per te permbushur sigurine e punetoreve ofron kushte te mira pune, ambjent te bollshem dhe duke perdorur lende te kontrolluara dhe pa efekte anesore. Punetoret jane te pajisur me uniforma dhe maska gjate proceseve te punes, zbatohet me rigorozitet rregullorja e higjenes se vendit te punes. Stafit eshte me eksperience ne kete fushe. Janë marrë masa për sigurimin teknik në ambientet e kompanisë, si dhe sistemimin e ambjenteve të punës

#### **○ Ndrichimi i objektit**

Furnizimi i objektit me rryme elektrike behet nga dy burime energjie, nga rrjeti elektrik i pushtetit lokal dhe ne raste avarie me motogjenorator. Kabllot elektrike jane te vendosur ne tuba çeliku per nje siguri me te larte dhe per te rritur masat ndaj zjarrit.

#### **○ Mbrojtja nga zjarri**

Ne zbatimin e gërmes b, te nenit 34, te Ligjit Nr.8766 date 05.04.2001 “Per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin”, jane marre masat e nevojshme per mbrojtjen ne raste rreziku apo renie zjarri. Per nje siguri maksimale ne ambjentet e punes nga drejtuesit e saj, jane marre te gjitha masat per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes nga zjarri.

Brenda objektit jane vendosur ne vende te dukshme paisje te mbrojtjes nga zjarri, si dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike.

Per mbrojtjen nga Zjarri jane marre masat e meposhtme:

- Ka fikese zjarri me kapacitet 50 kg (pluhur fosil dhe gaz karbonik).
- Ka nje depozite uji
- Ka rregullore te brendshme per mbrojtjen ndaj zjarrit.
- Personeli eshte i instruktuar me rregullat e mbrojtjes ndaj zjarrit.
- Hyrja per ne objekt ka hapesine te konsiderueshme per automjetet e zjarrfikeseve.

o **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes do te çojne perfundimisht ne perftimin e pamjeve te parashikuara ne projekt, me siperfaqe te pastra, te sistemuara e te gjelberuara.

### **3. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

#### **❖ Konkluzione**

Me e rendesishme per tu theksuar ne perfundim te ketij raporti te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte se ai do ti vije ne ndihme mbrojtjes se mjedisit.

- ✓ Ky aktivitet nuk perdor lende helmuese, te ngurta, te lengeta ose te gazta, te cilat po te shkarkohen ne ambjent demtojne mjedisin.
- ✓ Ushtrimi i ketij aktiviteti do te jape efekte pozitive ekonomike.
- ✓ Sistemimi i hapsirave, mbjellja me bar, peme dhe lule dekorative, do te permiresoje ne menyre te dukshme nga ana estetike ambjentin ekzistues.
- ✓ Mbajtja paster e mjedisit nga kontributi i vete punonjesve do te garantoje nje mjedis te paster ne territorin e ketij aktiviteti.

#### **❖ Rekomandime**

- Te respektohen te gjitha rregullat e sigurimit teknik ne ambjentet e punes.
- Te kontrollohet ne menyre periodike gjendja teknike e mjeteve te punes te cilat do te punojne gjate proceseve teknologjike.
- Punonjesit ne menyre periodike te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis ne kantier gjate ndertimit te objektit.
- Ne siperfaqet e lira ne kantierin e ndertimit dhe rreth tij te krijohet nje zone e gjelber e mbjelle me bar dhe drure dekorative.